

TAKIMI I TRETË 2023 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i tretë i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u zhvillua më datë **30.10.2023**.

Mbledhja u fokusua tek: forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me biznesin në AFP, prezantimin e ofertës arsimore aktuale në shkollat e “Hoteleri - Turizmit”, prezantimin dhe validimin e standardit të profesionit: **“Kuzhinier”** dhe standardit të kualifikimit profesional: **“Kuzhinë - Pastiçeri”**.

Në takim u theksua rëndësia e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit si mekanizëm kyç për adresimin e problematikave të sektorit, veçanërisht mungesën e fuqisë punëtore dhe lëvizshmërinë e saj. U diskutua nevoja për forcimin e bashkëpunimit mes arsimit profesional dhe biznesit, me fokus kalimin drejt një sistemi dual, ku bizneset kishin rol thelbësor në ofrimin e praktikave dhe trajnimin e nxënësve, të mbështetur nga shteti përmes përgatitjes së mentorëve. Gjithashtu, u hodh ideja e përfshirjes së nxënësve të shkollave profesionale në bizneset e turizmit gjatë sezonit veror.

Si problematikë kryesore u evidentua mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar pasi punonjësit largoheshin pas përfundimit të sezonit. Anëtarët e Komitetit Sektorial u informuan se, krahas shkollave profesionale, në Shqipëri kishte dhe një sërë Qendrash Publike të Formimit Profesional që ofronin kurse të formimit afatshkurtër. Anëtarët theksuan nevojën për politika mbështetëse që nxisin punësimin vjetor dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit. Gjithashtu, nënvizuan mungesën e statistikave të sakta për sektorin, të cilat ishin thelbësore për hartimin e ndërhyrjeve të duhura.

Në vijim të takimit, përfaqësuesi i ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, prezantoi ofertën arsimore të shkollave të “Hoteleri - Turizmit” për vitin shkollor 2023 - 2024, ku u evidentua pjesëmarrja e ulët e nxënësve në arsimin profesional krahasuar me vendet e tjera, si dhe lidhja e drejtpërdrejtë mes rritjes së cilësisë dhe rritjes së pjesëmarrjes. Përfaqësuesi i ministrisë hodhi idenë e përthithjes së emigrantëve për punësim në turizëm, duke theksuar nevojën për kontrata të cilat garantonin qëndrueshmëri.

Në pjesën e fundit të takimit, Sekretariati Teknik prezantoi anëtarët me kriteret e validimit për standardet e profesionit dhe standardet e kualifikimit profesional për të vijuar me prezantimin e standardit të profesionit: **“Kuzhinier”** dhe standardit të kualifikimit profesional: **“Kuzhinë - Pastiçeri”**. Sekretariati Teknik prezantoi funksionet dhe detyrat e standardit të profesionit, si dhe rubrikat me rezultatet e të nxënësve të standardit të kualifikimit profesional. Dokumentet u validuan nga anëtarët e Komitetit Sektorial pa ndryshime përmbajtësore.